



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 22 DHJETOR 2017**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 22. DECEMBRA 2017. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2017**

Rendi i ditës

1. Adresimi i Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, zoti Hashim Thaçi, deputetëve të Kuvendit të Republikës të Kosovës

Dnevni red

1. Obračanje Predsednika Republike Kosova, njegovog visočanstva g. Hashim Thaçi, poslanicima Skupštine Republike Kosova

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: I nderuar President i Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi,
I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj,
Zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misioneve diplomatike në Republikën e Kosovës, të akredituar në Prishtinë,
Të nderuar përfaqësues të organizatave joqeveritare,
Medie dhe ju të tjerë që jeni të pranishëm në këtë seancë,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Adresimi i Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, zoti Hashim Thaçi, deputetëve të Kuvendit të Republikës të Kosovës

Të nderuar deputetë,
Presidenti i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, në pajtim me nenin 84, paragrafi 30 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, do të mbajë fjalimin vjetor përkritazi me fushëveprimtarinë e tij.

E ftoj Presidentin e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, zotin Hashim Thaçi, që ta marrë fjalën.

Urdhëroni, i nderuar President!

(Duartrokitje)

PRESIDENTI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Veseli,

I nderuar Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, zoti Haradinaj,

Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misioneve ndërkombëtare,

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë Republikës së Kosovës,

Më lejoni që t'ju falënderoj juve të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës që ma keni dhënë këtë mundësi të raportoj përpara jush dhe qytetarëve tanë për punën time si President i Republikës së Kosovës, respektivisht për punën tonë të përbashkët në forcimin e shtetësisë së Kosovës.

Sigurisht, prioritet ynë i përbashkët mbetet gjithmonë angazhimi për përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve, jam angazhuar për respektim dhe fuqizim të të drejtave të njeriut për secilin qytetar të Republikës së Kosovës.

Duke filluar nga diskutimet për nevojën për përfaqësim të barabartë të gruas në të gjitha institucionet, e deri te Parada e Nderit, e kam bërë të qartë se:

Shteti i Kosovës, shoqëria kosovare, janë ndërtuar mbi parimet e lirisë dhe barazisë për secilin qytetar;

Kosova është shtet i të gjithë qytetarëve të saj dhe të gjithë duhet t'i gëzojnë të drejtat e barabarta në përpjekje për t'i realizuar aspiratat e tyre.

Kjo nënkupton që ne duhet të sigurojmë prosperitet dhe dinjitet për secilin qytetar, qoftë për punëtorin, për pensionistin, mjekun, policin, ushtarin, për mësuesin, studentin apo nxënësit në shkolla.

E dimë se për ta rritur mirëqenien e qytetarëve tanë, ne duhet ta zhvillojmë ekonominë tonë dhe ta rritim prodhimtarinë vendore.

Në shërbim të këtij qëllimi jam angazhuar në mënyrë aktive në promovimin e ekonomisë kosovare, të prodhimeve kosovare, në përfshirjen sa më të madhe të Diasporës në investimet në Kosovë.

Me konsolidimin e shtetit tonë, përkrahja e zhvillimit ekonomik të vendit ka filluar të zërë vend qendror në angazhimin tim si president, por edhe të institucioneve tjera të shtetit të Kosovës.

Në koordinim me institucionet relevante, e kam përkrahur nënshkrimin e kontratës për projektin "Kosovën e Re", që e sjell investimin më të madh privat në historinë e Kosovës, me 1,3 miliard euro investime, e që do të hapë mbi 10 mijë vende pune.

Dëshiroj ta uroj dhe përgëzoj Qeverinë e Kosovës për këtë angazhim dhe për këtë kontratë, por edhe ta uroj Kosovën dhe qytetarët e saj.

Përveç kësaj, unë vazhdoj të besoj se përmirësimi i infrastrukturës rrugore është kusht i domosdoshëm për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Prandaj, kam përkrahur përfundimin e projekteve për autostrada, që do ta lidhin Kosovën me rajonin e më gjerë, duke u mundësuar lëvizje më të lirë njerëzve dhe mallrave.

Sigurisht se sot ishte kënaqësi ta inauguronim edhe segmentin e dytë të autostradës “Arbër Xhaferi”, që e lidh Prishtinën me Shkupin.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se bazamenti kryesor i çdo shteti demokratik, duke përfshirë shtetin tonë, është sundimi i rendit dhe ligjit.

Asnjë fushë e shoqërisë sonë nuk mund të jetë funksionale në rast se ne nuk e fuqizojmë sundimin e rendit dhe ligjit dhe në rast se ne dështojmë të garantojmë se të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Kosova është shembull në rajon për të rikujtuar verifikimin dhe testimin, i cili është kryer nga viti 2008-2010 dhe i cili ka zgjatur tre vjet, me ç’rast është verifikuar dhe testuar secili gjyqtar dhe prokuror, që nga kryetari i Gjykatës Supreme e deri te kryeprokurori deri në nivelet më të ulëta.

Të gjithë kanë riaplikuar, rreth 35-37% e gjyqtarëve apo prokurorëve kanë rënë nga Kodi i Etikës apo verifikimi. Por, gjithmonë është i nevojshëm avancimi i reformës në Drejtësi.

Me dekretimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve nga komunitetet joshumicë, shumica nga të cilët punojnë në pjesën veriore të Kosovës, e kemi shtrirë rendin kushtetues e ligjor të Kosovës në çdo cep të shtetit tonë.

Për këtë qëllim, kam punuar me të gjitha institucionet e drejtësisë që ta vazhdojmë reformën dhe konsolidimin e Gjyqësorit për të garantuar që jo vetëm të kemi ligje të shkruara mirë, por edhe implementim të plotë të këtyre ligjeve.

Lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit janë dhe duhet të mbeten prioritetet.

Kosova nuk do të dorëzohet në përballje me këto sfida dhe nuk do të lejojë që vendi ynë të perceptohet si i korruptuar.

Heronjtë e sotëm janë ata që rreshtohen në luftë të pakompromis kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

I nderuar kryetar Veseli,

I nderuar kryeministër Haradinaj,

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,
Viti 2017 ishte vit i të arriturave, përkundër sfidave të shumta.

I kemi kaluar dy palë zgjedhje, ato të përgjithshmet në qershor dhe ato për kuvende komunale e kryetarë komunash, në tetor.

Këto dy procese elektorale e kanë dëshmuar edhe një herë pjekurinë e politikës dhe të shoqërisë kosovare, në përgjithësi.

Kjo i ka hapur rrugë formimit të Qeverisë së re, të cilën unë e mbështes fuqishëm, kuvendeve të reja komunale dhe zgjedhjes së kryetarëve të rinj të komunave të Kosovës, të cilët i uroj gjithashtu për zgjedhjen e tyre.

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe kryetarët e zgjedhur të komunave tani duhet të punojnë me përkushtim për realizimin e prioriteteve të përcaktuara dhe ta përmirësojnë jetën e qytetarëve.

Kur jemi të zgjedhjet e lira, më lejoni të theksoj se unë nuk kam hequr dorë nga puna ime që të punojmë bashkërisht me partitë politike për ta përfunduar me sukses procesin e reformës zgjedhore.

Unë konsideroj se pjesa më e madhe e punës në këtë drejtim ka përfunduar dhe gjatë vitit në vijim ne duhet ta përfundojmë këtë proces.

Me gjithë faktin se zgjedhjet qendrore dhe lokale kanë konsumuar shumë kohë dhe energji, prapëseprapë, si President në koordinim me institucionet tjera e kam vazhduar punën në realizimin e prioriteteve të rëndësishme shtetërore.

Ndër prioritet kryesorë në këtë aspekt ka qenë vazhdimi i punës për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës.

Ky është një proces shtetëror i natyrshëm dhe i domosdoshëm, i cili vjen edhe si rezultat i punës së pjesëtarëve të FSK-së, të cilët e kanë ngrehur nivelin e përgatitjes dhe tani janë të gatshëm për detyra e kompetenca të reja.

Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë shumetnike, në të cilën mbi 10% e pjesëtarëve të saj vijnë nga komunitetet joshumicë.

Forcat e Armatosura të Kosovës po ashtu do ta ruajnë dhe do ta fuqizojnë karakterin shumëtnik.

Tani jemi pothuajse në fazën përfundimtare të përpjekjeve tona për ta siguruar përkrahjen që procesi i themelimit të Forcave të Armatosura të Kosovës të bëhet nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese.

Këtë jemi duke e bërë dhe do ta bëjmë në koordinim të plotë me NATO-n dhe me partnerët e tjerë strategjikë.

Unë sot ju siguroj se bashkërisht me Qeverinë, me Kuvendin dhe me partnerët tanë strategjikë që do të punojmë që viti 2018 të jetë me të vërtetë viti i themelimit të të Forcave të Armatosura të Kosovës. Kjo do t'i kontribuojë paqes dhe stabilitetit në rajon dhe kudo në botë, meqë do të jetë një ushtri moderne dhe multietnike.

Kur jemi të siguria e Kosovës, më lejoni të theksoj se jam krenar që shteti ynë është lider në rajon në luftimin e ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit.

Ky përkushtim yni ka marrë mirënjohje nga të gjithë liderët e botës së lirë e demokratike.

E shfrytëzoj këtë rast që t'i falënderoj të gjithë mekanizmat e sigurisë kombëtare që kanë kontribuar në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në Kosovë, por edhe në rajon.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

E kaluara jonë është e dhimbshme dhe kujtimet për vuajtjet tona ende mbeten të freskëta.

Por, e kaluara jonë është edhe ajo që na bën krenarë dhe na jep forcë për të shikuar me këmbëngulje nga e ardhmja.

Për këtë qëllim, me përkushtim e kam vazhduar punën për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin, që synon t'i ndihmojë përpjekjet e shoqërisë sonë për mbylljen e kapitullit të luftës, të armiqësive dhe arritjen e pajtimit të ndërsjellë. Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin nuk e sfidon drejtësinë, përkundrazi e vërteta e ndihmon drejtësinë.

Prandaj, jam i lumtur që pas një pune të madhe kemi arritur ta themelojmë ekipin përgatitor për Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin.

Jam i sigurt se puna e këtij komisioni do të japë rezultate konkrete gjatë vitit 2018 dhe me këtë rast dua t'i falënderoj organizatat e familjeve të të pagjeturve, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen e tyre.

Dialogu mbetet mekanizmi i vetëm dhe i pazëvendësueshëm për zgjidhjen e problemeve brenda shtetit tonë, por edhe me shtetet tona fqinja.

Në kuadër të angazhimit tim për ndërtimin e paqes së qëndrueshme në tërë Evropën Juglindore, është edhe përkushtimi ynë i përbashkët në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Tani jemi gati për ta vazhduar fazën përfundimtare të këtij procesi, i cili do të vazhdojë të ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe të përkrahet fuqishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Sigurisht se kjo fazë përmbyllëse nuk do të jetë aspak e lehtë.

Për këtë qëllim i kam filluar konsultimet formale dhe joformale me partitë politike dhe shoqërinë civile, me qëllim që ta themelojmë një Grup të Unitetit për të siguruar gjithëpërfshirje në këtë proces.

Unë edhe sot ju bëj thirrje publike që të jemi të bashkuar në këtë proces dhe në çdo proces tjetër, që është me interes shtetëror.

Sa herë jemi bashkuar, Kosova ka fituar dhe qytetarët tanë na kanë mbështetur.

Kështu duhet të jetë përsëri, sepse e ardhmja jonë, integrimi i shtetit tonë në strukturat veriatlantike varet në masë të theksuar nga ky proces.

Në çdo rrethanë, unë ju siguroj ju, të nderuar deputetë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës, se procesi i dialogut do të jetë transparent dhe se çdo marrëveshje e arritur do të ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar Veseli,

I nderuar kryeministër Haradinaj,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kredibiliteti ynë shtetëror në arenën ndërkombëtare dhe shpejtësia me të cilën i afrohem anëtarësimit në BE dhe NATO varet kryesisht nga serioziteti ynë në përmbushjen e obligimeve tona shtetërore.

Në këtë aspekt, ne nuk mund që në vazhdimësi ta drejtojmë gishtin nga BE-ja, NATO-ja apo bashkësia ndërkombëtare, duke kërkuar që t'i mbajmë ata fajtorë të vetëm për ngecjet tona.

Ne duhet t'i pranojmë lëshimet tona dhe t'i përmirësojmë ato sa më shpejt që mundemi, sepse vetëm kështu mund ta zëmë hapin me shtetet fqinja në procesin e integriteteve euroatlantike.

Prandaj, duhet ta ratifikojmë pa humbur kohë marrëveshjen për shënimin e vijës kufitare me Malin e Zi.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje i jep fund izolimit të padrejtë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Janë inkurajuese bisedat e fundit që janë duke u zhvilluar në kuadër të institucioneve të Kosovës, të përfshirë të gjithë, edhe Kuvendi, edhe Qeveria, edhe të gjithë njerëzit vullnetmirë, ekspertë vendorë e ndërkombëtarë, që të gjendet një zgjidhje sa më shpejt që është e mundur, pra në javët e ardhshme.

Duhet që pa humbur kohë ta themelojmë Asociacionin e Komunave me shumicë serbe në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese, sepse BE-ja dhe shumë shtete tjera partnere janë të zhgënjyera me paaftësinë tonë për t'i zbatuar zotimet e marra përsipër.

Sa më shpejt t'i përmbushim detyrat tona, aq më shpejt do të mund të bëjmë hapa seriozë drejt anëtarësimit në BE dhe në NATO.

Si President i Republikës së Kosovës, vazhdimisht i kam bërë thirrje Bashkimit Evropian, për veprime, jo vetëm teknike, por mbi të gjitha strategjike, për anëtarësimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

Më vjen mirë që tani së fundmi edhe Bashkimi Evropian e thotë qartë se mënyra më e mirë për ta siguruar paqen afatgjatë në rajonin tonë është anëtarësimi i të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

Unë vazhdoj të besoj se mënyra më e mirë është që të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor të anëtarësohen në BE në të njëjtën kohë, pavarësisht faktit se disa shtete kanë bërë progres më të madh në përmbushjen e kriterëve për anëtarësim.

Unë dua të besoj se Qeveria e Kosovës do të vazhdojë me përkushtim thellimin e reformave edhe në Legjislacion, edhe në ekonomi, edhe në politikë, edhe me qeverisjen e mirë, në mënyrë që të përmbushen obligimet që kemi në këtë proces të anëtarësimit.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Një kohë të konsiderueshme të punës sime ua kam kushtuar edhe përpjekjeve për konsolidimin e shtetit të Kosovës në skenën ndërkombëtare.

Vitin 2017 e fillova me vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe takim me Zëvendëspresidentin e atëhershëm Biden, ndërsa e vazhdova me vizitën tjetër në SHBA në shtator, duke u takuar Zëvendëspresidentin e tashëm, Pence.

Këto dy vizita kanë konfirmuar edhe një herë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbeten partner i Republikës së Kosovës dhe se Uashingtoni mbetet i përkushtuar për paqen dhe stabilitetin e qëndrueshëm në Kosovë dhe në rajon.

Por, pjesë e këtij partneriteti është edhe përgjegjësia jonë që të sillemi si shoqëri dhe si shtet i pjekur politikisht, i gatshëm të luajë rol konstruktiv në rajon dhe më gjerë, duke ndërtuar marrëdhënie të mira fqinjësore me të gjitha shtetet e rajonit.

Gjatë këtij viti kam realizuar vizita bilaterale dhe kam marrë pjesë në forume dhe konferenca të ndryshme.

Me këtë rast dua t'i veçoj edhe vizitat bilaterale në Kanada, në Kroaci e në Turqi, pastaj në Bullgari, në Austri, si dhe në Jordani. Jam nderuar me audiencë tek Ati i Shenjtë, Papa Françesku.

E kam përfaqësuar Kosovën në Konferencën e Sigurisë në Munihi të Gjermanisë, në Forumin Ekonomik Ndërkombëtar në Jordani, në Konferencën Ndërkombëtare të Sigurisë në Halifax, në Forumin e Kroacisë dhe në Samitin Bërdo-Brione e forume tjera.

Në këto forume dhe konferenca, ndër të tjera, me krenari e kam prezantuar transformimin e Kosovës nga një konsumues i mekanizmave të paqes e sigurisë në një promovues dhe kontribuues të paqes dhe bashkëjetesës ndërmjet popujve.

Kjo e ka forcuar bindjen në botë se pavarësia e Kosovës ka sjellë paqe të qëndrueshme në tërë Evropën Juglindore.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Qytetarët e Republikës së Kosovës kanë treguar qartë se duan t'i shohin liderët e tyre të zgjedhur politikë të bashkuar në të gjitha çështjet e interesit nacional dhe shtetëror.

Prandaj, është detyrë imja, detyra juaj si deputetë, detyrë e të gjithë neve që të punojmë pa u ndaluar për të mirën tonë të përgjithshme.

Si President i Republikës së Kosovës do ta përcjell me vëmendje punën e institucioneve shtetërore në përmbushjen e aspiratave dhe synimeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Prandaj, uroj që të na prijë e mbara në realizimin e qëllimeve tona të mira në shërbim të qytetarëve dhe shtetit tonë.

Le të jetë viti 2018 vit i unitetit politik e qytetar të Kosovës.

Në fund, të nderuar deputetë, qytetarë të Republikës së Kosovës, pasi jemi në prag të festave të fundvitit, më lejoni t'ju uroj paqe, shëndet, gëzim e lumturi juve dhe familjeve tuaja, çdo qytetari të Republikës së Kosovës.

Për shumë mot, urimet më të mira për Kërshëndellat dhe gëzuar Vitin e Ri! Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: E falënderojmë Presidentin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, për fjalimin vjetor para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me urimet më të mira për festat e fundvitit!

Të nderuar kolegë deputetë,
Me kaq e mbyll këtë seancë plenare. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*